



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 12
Prishtinë, më 20 maj 2008, ora 12:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL
i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale

Në mbledhje morën pjesë: Sadik Idriz, Rita Hajzeraj, Slllobodan Petroviq, Nurishahe Hulaj, Bujar Bukoshi, Armend Zemaj, Gjylnaze Syla, Qamile Morina dhe Teuta Hadri.

Munguan: Mimoza Ahmetaj dhe Flora Brovina.

Të pranishëm - nga Zyra e Komisioneve të Kuvendit: Shpresa Haxhijaj - administratore, Drita Morina - zyrtare e lartë ligjore, Fatime Qorri - zyrtare ligjore dhe Mirjeta Heta - nëpunëse administrative.

Nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale: Gjylnaze Novobërdaliu-Gola, Minire Begaj-Balaj dhe Rejhane Zylfijaj.

Nga Zyra e Presidentit të Kosovës: Nexhat Shatri.

Mbledhjen e kryesoi z. **Sadik Idriz**, kryetar i Komisionit.

Komisioni i zhvilloi punimet me këtë

REND DITE

1. **Miratimi i rendit të ditës;**
2. **Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;**
3. **Miratimi i raportit nga vizita në Institutin Special të Shtimes;**
4. **Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të Kufizuara;**
5. **Të ndryshme.**

1. Miratimi i rendit të ditës

Teuta Hadri - Tha se në rendin e ditës nuk është paraparë që në këtë mbledhje do të prezantojnë edhe përfaqësuesit e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Kryetari konstatoi se rendi i ditës u miratua pa plotësime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar

Procesverbali i mbledhjes së kaluar u miratua pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit nga vizita në Institutin Special të Shtimes

Sadik Idriz - Tha se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale më 13 maj 2008, në orën 11: 00, e ka vizituar Institutin Special të Shtimes.

Ai i ftoi anëtarët e Komisionit që të votojnë për raportin e kësaj vizite.

Kryetari konstatoi se raporti nga vizita në Institutin Special të Shtimes u miratua pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët se Komisioni për Buxhet dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më 14 maj 2008 e ka shqyrtuar Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara me raportin e Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale. Në këtë mbledhje nga Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale kanë marrë pjesë deputetja Flora Brovina, si raportuese e këtij Projektligji dhe deputeti Armend Zemaj, që njëherësh është edhe anëtar i Komisionit për Buxhet dhe Financa. Ai e hapi diskutimin për këtë pikë të rendit të ditës.

Teuta Hadri – Tha se në tabelën krahasuese për Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara nuk figuron amendamenti i propozuar nga ajo. Komisioni për Buxhet dhe Financa nuk e ka shqyrtuar fare këtë propozimamendament. Ajo tha se asnjë Komision nuk mund ta ndalojë të drejtën e saj si deputete për të propozuar amendament. Ajo e ka dorëzuar në Zyrën për Parashtresa amendamentin e saj në pajtim me rregullat procedurale për amendamente dhe si të tillë Komisioni për Buxhet është dashur ta shqyrtojë.

Armend Zemaj – Tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka shqyrtuar me kujdes Projektligjin për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Ky Projektligj bie ndesh me politikën tatimore, si dhe me Ligjin mbi menaxhimin e financave publike. Ai ishte i mendimit se lidhur me këtë projektligj ky komision nuk mund të punojë nëse nuk janë prezentë përfaqësuesit nga Ministria për Ekonomi dhe Financa, konkretisht nga Departamenti për Buxhet. Sa i përket amendamentit të deputetes Teuta Hadri, ai u është shpërndarë të gjithë anëtarëve të Komisionit për Buxhet dhe Financa, por nuk është shqyrtuar fare, me arsyetimin se nuk u është drejtuar anëtarëve të këtij komisioni për shqyrtim, por u është drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës.

Gjylnaze Sylja – Tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa është dashur të japë sqarime më të hollësishme rreth implikimeve buxhetore të këtij projektligji. Ajo propozoi që ky komision t`ia

propozojë seancës një rekomandim për kohën shtesë, derisa Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale ta dorëzojnë një propozim konkret.

Gjynaze Novobërdaliu-Gola - Tha se Komisioni për Buxhet dhe Financa ka pasur vërejtje përkitazi me implikimet buxhetore të Projektligjit për rehabilitimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara. Këto vërejtje janë të fokusuara sidomos lidhur me nenin 12. Ajo tha se i ka konsultuar praktikantët e shteteve, si: Sllovenia, Kroacia, Bosnja, si dhe praktikantët e Malit të Zi, në mënyrë që të zbutet pak kostoja financiare që buxheti i Kosovës nuk mund ta përballojë. Më e arsyeshme është konsideruar praktika e Kroacisë, që ka paraparë se çdo i 49-ti punëtor i punësuar të jetë person me aftësi të kufizuara. Sa u përket vërejtjeve për nënkodin buxhetor, është çështje për të cilën më së miri përgjigjen përfaqësuesit e Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave.

Minire Begaj-Balaj – Tha se problem është konsideruar edhe njëpërqindëshi që është paraparë me këtë projektligj. Në kohën kur është hartuar ky projektligj, ka qenë në procedurë edhe një ndryshim në Ligjin për kontribute. Sa u përket objekteve fizike, ata kanë propozuar të shfrytëzohen qendrat ekzistuese për rehabilitim profesional, që janë në shtatë qendra të Kosovës. Ata kanë menduar se do të ketë kursime në mënyrë që t'i ofrohen kësaj kostoje të lartë të këtij projektligji. Në momentin e punësimit të këtyre personave, këta do të hiqen nga skema sociale dhe do t'i paguajnë kontributet e tyre si të gjithë të punësuarit te tjerë.

Rejhane Zylfijaj - Tha se do të ishte mirë që implikimet buxhetore të diskutohen në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa, në mënyrë që të gjendet zgjidhje. Fatkeqësisht ky ligj nuk është përfshirë në kornizën afatmesme të shpenzimeve. Megjithatë ajo konsideroi se ky ligj do të jetë mjaft tërheqës për donatorët. Sa i përket nenit 12, në të cilin parashihet që çdo i 25-ti punëtorë i punësuar të jetë person me aftësi të kufizuara. Ajo tha se ndoshta më e arsyeshme do të ishte që ky numër të jetë çdo i 49-ti.

Nurishahe Hulaj – Tha se me disa korrigjime të vogla ky ligj mund të kalojë. Ajo kërkoi të bëhet një memorandum shpjegues nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe nga Ministria për Punë dhe Mirëqenie Sociale, që t'i vlerësojnë implikimet buxhetore për tre deri katër vjetët e ardhshëm, në mënyrë që Komisioni në mbledhjen ardhshme të shqyrtojë atë memorandum.

Sadik Idriz – Tha se rekomandimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa është mjaft i qartë. Ai tha se ministritë përkatëse janë ato që duhet t'i dorëzojnë propozimet konkrete lidhur me këto implikime buxhetore. Si Komision në mbledhjet e radhës mund t'i ftojë përfaqësuesit nga MEF-i dhe nga MPMS-ja për të marrë informata, nëse buxheti i Kosovës mund t'i përballojë këto implikime.

Qamile Morina – Tha se Komisioni duhet ta zgjidhë problemin që ka të bëjë me nenin 12. Sa u përket problemeve që kanë dalë lidhur me implikimet buxhetore, ajo tha se ky ligj për herë të parë i është dorëzuar Kuvendit të Kosovës në vitin 2007. Ka qenë e paraparë që ky ligj të zbatohet në vitin 2011. Në dokumentacionin e dorëzuar ky ligj ka pasur edhe llogaritjet buxhetore dhe në këto llogaritje kanë qenë të përfshira edhe objektet fizike. Në këto llogaritje ka qenë paraparë edhe buxheti për një qendër rehabilituese në Ferizaj. Ajo e parashitroi pyetjen se sa objekte rehabilituese i ka Kosova dhe a janë këto objekte që bëjnë rehabilitimin dhe vlerësimin e këtyre personave sa janë të aftë për punë?

Komisioni duhet të angazhohet që ky ligj të kompletohet sa më parë dhe të mund të zbatohet. Ajo tha se ka propozuar amendamentete që ky Komision nuk i ka përkrahur. Sipas atyre propozimamendamenteve, çdo person me aftësi të kufizuara që dëshiron të punësohet, kalon nëpër qendrën e rehabilitimit, që e bën vlerësimin në mënyrë të precizuar. Personat që mund ta bëjnë një të tretën e punës së personit normal, do të jenë persona që e fitojnë të drejtën për të konkurruar për

kuotën dy për qind. Për personat, që nuk mund të arrijnë të rehabilitohen për punë, do të hapen punëtori sociale, pastaj ndoshta duhet të mendohet për ndonjë ligj për këto punëtori. Ajo tha se këtij ligji duhet t'i bëhet një analizë e mirë për të vlerësuar nëse këto implikime buxhetore do të jenë shumë të mëdha.

Rita Hajzeraj – Pasi i falënderoi përfaqësuesit e MPMS-së, tha se përderisa Qeveria e ka pranuar këtë projektligj, ajo është dashur t'i shikojë edhe implikimet buxhetore. Është e kotë të miratohet një ligj që nuk mund të zbatohet deri në vitin 2011. Sa i përket përcaktimit të aftësisë për punë, ajo konsideron se është e panevojshme që me ligj të përfshihet ky përcaktim, pasi këtë e bëjnë këshillat dhe komisionet e caktuara me ligj.

Komisioni për Buxhet dhe Financa është dashur të ofronte të dhëna më të hollësishme lidhur me implikimet buxhetore.

Minire Begaj-Balaj – Tha se në Kosovë janë shtatë qendra të aftësimin. Sistemi i aftësimin në këto qendra është modular. Në këto qendra bëhet aftësimi i të gjithë personave, pasi nuk mund as të diskutohet që personat me aftësi të kufizuara të aftësohen në qendra të ndara, sepse kjo përbën diskriminim. Në këto qendra aftësimi i personave bëhet në përputhshmëri me nevojat e tyre, p.sh.: personat e verbër e kanë alfabetin e Brajtit etj. Sa i përket kategorizimit të këtyre personave ekzistojnë komisionet që merren me vlerësimin e tyre.

4. Të ndryshme

Sadik Idriz – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në Kuvend është proceduar Projektligji për punë. Ai tha se në seancën e radhës ky projektligj do të jetë në rendin e ditës për leximin e parë. Komisioni mund të mbajë mbledhje për ta pasur një qëndrim edhe para leximit të parë në seancë.

Gjynaze Syla - Tha se për shkak të rëndësisë që e ka Ligji për punën, propozoi që Komisioni para leximit të parë të këtij projektligji ta paraqesë një rekomandim për seancë. Ajo kërkoi që materiali nga mandati i kaluar lidhur me këtë projektligj t'u shpërndahe anëtarëve të këtij komisioni në mënyrë që ta shqyrtojnë me kujdes.

Rita Hajzeraj - Tha se nuk është e kënaqur me punën e deritanishme të këtij komisioni. Ne duhet t'i shqyrtojmë të gjitha ligjet nen për nen e nëse është nevojta edhe me një orar më të zgjatur.

Nurishahe Hulaj – Tha se grupet e punës janë ato që mblidhen për të hartuar propozime konkrete lidhur me ligjet. Propozime mund të bëjë secili anëtar i Komisionit, për të cilat pastaj vendos Komisioni.

Kryetari e shpalli mbledhjen të mbyllur në orën 13:00

Përgatitur nga
Zyra e Komisioneve të Kuvendit

Kryetari i Komisionit,
Sadik Idriz